



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. Extra Prot.

Tiranë më 23. 07. 2020

VENDIM

“Mbi zgjidhjen e menjëhershme të kontratës të punës të personelit akademik me kohë të plotë dhe Zv/Kryetare e Senatit Akademik të UT, Zj.Eliona Kulluri(Bimbashi), nga Rektori i UT dhe veprimtarinë e institucioneve zgjedhore të UT”

Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë neni 57, pika 7, ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 3, pika 4, gërma a; neni 36, pika 1; neni 37; neni 38, pika 1, gërma a; neni 65; neni 68; Statutin e UT neni 29; neni 30; neni 31; neni 32; neni 75; neni 76; neni 77; Kodin e Procedurave Administrative nenet 108,109, 110, 111; Vendimin nr.Extra prot. datë 21.05.2020 si dhe në propozimet e anëtarëve të Senatit, në mbledhjen e datës 23.07.2020 Senati Akademik i Universitetit të Tiranës;

VENDOSI:

1.Të konstatojë pavleshmërinë absolute të vendimit nr.74 datë 17.07.2020 të Rektorit të UT për zgjidhjen në mënyrë të menjëhershme, të kontratës të punës për personelin akademik me kohë të plotë **Zj. Eliona Kulluri(Bimbashi)** dhe Zv/Kryetare e Senatit Akademik të UT, dhe vazhdimin e marrëdhënieve të punës të saj me Universitetin e Tiranës në Njësinë Kryesore përkatëse.























Referimi tek Kodi i Punës nuk ka relevancë ligjore për punësimin dhe ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për personelin akademik, i cili rregullohet nga Ligji për Arsimin e Lartë dhe Statuti i UT.

2.Mbështesim të gjitha organet zgjedhore të UT, si organe zgjedhore legjitime dhe inkurajojmë veprimtarinë e tyre, si veprimtari të pavarur, të paanshme nga strukturat e tjera akademike për realizimin e demokracisë të brendshme të Universitetit të Tiranës nëpërmjet zhvillimit të procesit zgjedhor.

3.Ky vendim të shpallet në të gjitha faqet zyrtare elektronike të Njësive Kryesore, për njohje dhe zbatim nga të gjitha strukturat përkatëse të UT.

4.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UT

1. Prof. Edvard Rypki 
2. Emileto Pauleymani 
3. Anilo Poyoult 
4. Esmerolde Krauidlo 
5. ARTUR SULA 
6. Spuro Dmsuku 
7. Dejana Collogjerovic 
8. ANIAN HOXHA 
9. Shygyu Plaw 
10. VIKTOR RUSTANIC 
11. Sobel Axkemi 
12. Semra Jusupovic 
13. Lestrela Kabro 
14. Arkemisi Doro Suel 
15. Rea Kotani 
16. ICIR RUSI 
17. Dhoni Kule 
18. Bri Kena Koptadaj 
18. Gebmit Menber 
20. Elwona Kullivi (Bimsadi) 
21. Kristian Kina 
22. Sulo Haden 
23. Sawone Pahr 